



DIPLOMACIA PARLAMENTARE: BASHKËPUNIMI RAJONAL PËRMES DIALOGUT TË PËRFORCUAR PARLAMENTAR

RAPORTI I MONITORIMIT 2

Dhjetor 2023 - Prill 2024

**INSTITUTI
I STUDIMEVE
POLITIKE (ISP)**

Shqipëri, 2023

supported by:



CRTA:



institut
alternativa



The project "Parliamentary Diplomacy: Regional Cooperation Through Enhanced Parliamentary Dialogue" is led by the Institute for Democracy (IDSCS) with the partners from the Western Balkan region: Institute Alternativa (IA), Institute for Political Studies (ISP), CRTA - Center for Research, Transparency and Accountability, Kosova Democratic Institute (KDI), and the Network of Progressive Initiatives (NPI). You can find more about the project at the following link: <https://idscs.org.mk/en/2023/06/23/parliamentary-diplomacy-regional-cooperation-through-enhanced-parliamentary-dialogue/>

Pala përgjegjëse	Instituti i Studimeve Politike
Titulli i projektit	Diplomacia Parlamentare: Bashkëpunimi Rajonal Përmes Dialogut të Përforcuar Parlamentar
Kohëzgjatja e planifikuar e projektit:	Maj 2023 – Prill 2025
Buxheti total i projektit	44.582,4 EUR
Mbështetur nga	Zyra e Jashtme Federale Gjermane, (Maqedonia e Veriut)
Personat e kontaktit (emri/pozicioni/informacioni i kontaktit)	z. Afrim Krasniqi Drejtor Ekzekutiv +355 69 209 8999
Numri i raportit të monitorimit	Nr. 2
Periudha e raportimit:	Dhjetor 2023 - Prill 2024
Data e dorëzimit të këtij raporti	10 maj 2024



DIPLOMACIA PARLAMENTARE: BASHKËPUNIMI RAJONAL PËRMES DIALOGUT TË PËRFORCUAR PARLAMENTAR

Projekti “Diplomacia parlamentare: Bashkëpunimi rajonal përmes dialogut të përforcuar parlamentar” udhëhiqet nga Instituti për Demokraci (IDSCS) - Maqedonia e Veriut me partnerët nga rajoni i Ballkanit Perëndimor: Instituti Alternativa (IA) - Mali i Zi, Instituti për Studime Politike (ISP) - Shqipëri, QKTLL - Qendra për Kërkime, Transparencë dhe Llogaridhënie - Serbi, Instituti Demokratik i Kosovës (IDK) - Kosovë dhe Rrjeti i Iniciativave Progresive (RrIP) - Bosnjë dhe Hercegovinë.

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti: Qëllimi i projektit është të rrisë bashkëpunimin rajonal në shumë nivele për të konsoliduar dhe ruajtur dinamikën e procesit të integritimit në BE.

Objektivat specifike:

1. Forcimi i bashkëpunimit rajonal në nivel parlamentar;
2. Rritja e përgjegjësisë lokale dhe zbatimi i angazhimeve të Procesit të Berlinit;
3. Roli mbikëqyrjes i parlamenteve të BP-së në pushtetin ekzekutiv.

KONTEKSTI

Në Ballkanin Perëndimor, parlamentet, megjithëse zyrtarisht janë institucionet më të larta në sistemet politike, shpeshherë nuk kanë pavarësi, siç dëshmohet nga shtrembërimi i mekanizmave të kontrollit dhe balancimit në favor të ekzekutivit, duke ngritur shqetësime për prapakthimin demokratik. Megjithëse janë njohur si të rëndësishëm në nisma si Procesi i Berlinit (PB), parlamentet u përjashtuan kryesisht deri së fundmi, duke kufizuar pjesëmarrjen e tyre në përpjekjet e bashkëpunimit rajonal.

Forcimi i kapaciteteve parlamentare, veçanërisht në fusha të tilla si Tregu i Përbashkët Rajonal (TPR) dhe Agjenda e Gjelbër, mund të rrisë ndikimin e tyre në nivel kombëtar dhe rajonal. Zhvillimet e fundit, si ratifikimi i marrëveshjeve që lidhen me parimet dhe vlerat e BE-së, duke përfshirë Marrëveshjen për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale, kanë theksuar rëndësinë e mbikëqyrjes dhe angazhimit parlamentar, siç dëshmohet nga shqyrtimi i proceseve legjislativ nga Komisioni i Çështjeve Evropiane.

Megjithatë, ekziston një mungesë e dukshme komunikimi midis degëve ekzekutive dhe legjislativ për nisma si Plani i Rritjes, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes së parlamentit në zbatimin dhe mbikëqyrjen e këtyre masave për të siguru-

ar që ato të sjellin përfitime të drejtpërdrejta për qytetarët.

METODOLOGJIA

Metodologjia e monitorimit për vlerësimin e zbatimit të angazhimeve në kuadër të Procesit të Berlinit, me fokus në Tregun e Përbashkët Rajonal (TPR) dhe Agjendën e Gjelbër për rastin e Shqipërisë, ndjek një qasje sistematike dhe rigoroze. Raporti, i hartuar për deputetët dhe stafin e tyre, përqendrohet te arritjet kryesore të Planeve të Veprimit të TPR dhe Agjendës së Gjelbër, siç janë parashikuar nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal.

Kërkimi përfshin një analizë të thelluar të shkallës së zbatimit dhe identifikimin e institucioneve përgjegjëse për të adresuar ngërçet ekzistuese. Metodatat e mbledhjes së të dhënave përfshijnë studim të dokumentave dhe komunikim të vazhdueshëm (Kërkesa për Informacion) me institucionet përgjegjëse: Parlamentin e Shqipërisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe njësitë e qeverisjes vendore.

Analiza e të dhënave përfshin analiza tematike, analizën e përmbajtjes së përgjigjeve nga ministritë përkatëse dhe statistika përshkruese bazë. Struktura përfundimtare e raportit përfshin një model monitorimi, i cili përshkruan aktivitetet dhe hapat e ardhshëm, si dhe një vlerësim të shkallës së zbatimit dhe rekomandime për forcimin e mbikëqyrjes parlamentare.

I. PËRSHKRIM I SHKURTËR MBI MARRËVESHJET, KONTEKSTI SHQIPTAR

Procesi i Berlinit ka një rëndësi të veçantë për vendet e Ballkanit Perëndimor (VBP), pasi ndihmon në bashkëpunimin e mëtejshëm në fusha konkrete midis vendeve dhe përshpejton procesin e integritimit evropian. Vendet e Ballkanit Perëndimor, konsiderohet që duhet të ecin në dy drejtime: të forcojnë institucionet e brendshme, të kapërcejnë konfliktet dhe të vazhdojnë në mënyrë të qëndrueshme me bashkëpunim të shtuar ndërmjet tyre. Në këtë drejtim, siç është reflektuar në raportin e mëparshëm, VBP kanë ratifikuar tre marrëveshje që tregojnë interes dhe marrëdhënie të mira fqinjësore. Marrëveshjet, që gjithashtu lidhen me katër liritë e lëvizjes brenda BE-së (mallrat, kapitalet, personat dhe shërbimet), përfshijnë profesione të ndryshme. Këto marrëveshje janë:

1. Liria e Lëvizjes me Kartë Identiteti,
2. Njohja e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë,
3. Njohja e Kualifikimeve Profesionale për Doktorë të Mjekësisë, Stomatologë dhe Arkitektë.

Pas Samitit të fundit të Procesit të Berlinit të mbajtur në Tiranë më 16 tetor 2023, ka pasur angazhime të ndryshme për përmirësimin e integritimit të ekonomive të Ballkanit Perëndimor, në përputhje me parimet dhe vlerat e BE-së. Në këtë drejtim u theksua **vazhdimësia e bashkëpunimit** në fusha si **lidhja, transporti, tregtia,**



energjia dhe lidhjet digjitale në Ballkanin Perëndimor, si dhe midis rajonit dhe BE-së¹.

Një nga çështjet kryesore të diskutuara dhe për të cilat u arrit marrëveshje ishte domosdoshmëria për të zvogëluar hendekun midis ekonomive të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, gjë që mund të ndihmohet nga Plani i Rritjes dhe Tregu unik i pagesave.

Gjatë Samitit, u nënshkrua një marrëveshje e re, konkretisht Marrëveshja për njohjen e kualifikimeve profesionale për infermierët, veterinerët, farmacistët dhe mamitë, në kontekstin e marrëveshjes së tregtisë së lirë të Evropës qendrore. Kjo marrëveshje, është dërguar në Kuvend dhe është miratuar pa vonesë, botuar në gazetën zyrtare më 11 mars 2024² dhe tani ka hyrë në fuqi.

II. PËRFSHIRJA E DEPUTETËVE SHQIPTARË NË PROCESIN E BERLINIT

Në Shqipëri, marrëveshjet: 1) Liria e lëvizjes me karta identiteti; 2) Njohja e kualifikimeve të arsimit të lartë; 3) Njohja e kualifikimeve profesionale për doktor të mjekësisë, stomatologë dhe arkitektë, janë miratuar me dekret të qeverisë, siç është raportuar më parë. Për shkak të këtij vendimi të Qeverisë, Komisioni i Çështjeve Evropiane mbajti dy seanca dëgjimore me ministrinë

përkatese për të kuptuar arsyetimin dhe mungesën e informimit të Kuvendit siç e kërkon Kushtetuta.

Marrëveshja për njohjen e kualifikimeve profesionale për infermierët, veterinerët, farmacistët dhe mamitë, në kontekstin e marrëveshjes së tregtisë së lirë të Evropës qendrore, ndryshe nga tre ato të përmendura më lart, është dërguar në Kuvend dhe është miratuar pa vonesë.

Komisioni i Çështjeve Evropiane e ka shqyrtuar këtë ligj me 13 prill 2024. Gjatë diskutimeve deputetët e Komisionit i kanë bërë Ministrisë së Arsimit dy pyetje themelore: Pse qeveria ka ndryshuar procedurën me këtë projektligj në krahasim me ato të mëparshmet, pasi tre marrëveshjet e tjera janë miratuar me dekret qeveritar ndërsa për marrëveshje e fundit ka ndjekur procedurat parlamentare? Pyetja e dytë ishte në lidhje me studimin e mundshëm të fizibilitetit mbi të dhënat konkrete, lidhur me nevojën dhe ndikimin e marrëveshjes për qytetarët³. Komisioni nuk mori përgjigje të kënaqshme për pyetjet e ngritura dhe kërkoi që përgjigjet të dërgoheshin me shkrim nga Ministria.

Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes është diskutuar edhe në 4 komisione të tjera: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut⁴, Komisioni për Arsim, Media dhe

1 https://www.berlinprocess.de/uploads/documents/chairs-conclusions-berlin-process-summit-2023_1697629712.pdf

2 <https://qbz.gov.al/eli/fz/2024/63/b996623b-c372-461f-a451-bc237bb961f6;q=%20njohja%20e%20kualifikimeve%20profesionale%20t%C3%AB%20infermier%C3%ABve,%20kirurg%C3%ABve%20veterinare,%20farmacist%C3%ABve%20dhe%20mamive>

3 <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404091444590910Procesverbal%2C%20dat%C3%AB%2018.03.2024.pdf>

4 <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202403191306492576Raport-Ratifikimi%20mveshje%20per%20njohjen%20e%20kualifikime.pdf>

Informim Publik⁵, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë⁶ dhe Komisioni për Punët e Jashtme⁷.

Sipas procedurës, projektligji është diskutuar dhe miratuar në seancën plenare të⁸ datës 21.03.2024.

Në këtë këndvështrim, ndërgjegjësimi mbi ndikimin të kësaj marrëveshjeje është shumë më i madh se ato të mëparshmet, duke marrë parasysh diskutimet në komisione të ndryshme parlamentare dhe në seancën plenare të cilat transmetohen drejtpërdrejt ndërsa **rregjistrimet audio-visualë mund të gjenden në faqen e internetit të Kuvendit.**

Megjithatë, pas samitit të Procesit të Berlinit, në Tiranë, Kuvendi ende nuk është informuar për diskutime të mëtejshme dhe angazhimet e tjera të mundshme në kuadër të kësaj iniciative.

Deri më tani, janë marrë vendime të rëndësishme në kuadër të Procesit të Berlinit në të cilin BE-ja është angazhuar plotësisht për të mbështetur vendet e Ballkanit Perëndimor në përpjekjet e tyre për t'u afruar me standardet e BE-së. Nga njëra anë, BE-ja ka theksuar në dokumentin e Planit të Rritjes se ekziston një hendek prej 35% midis VBP-së dhe BE-së. Nga ana tjetër, një nga vendimet më të fundit të Parlamentit

Evropian është miratimi i Planit të Rritjes, i cili mbështet reformat dhe veprimet e nevojshme për të reduktuar këtë hendek dhe për të rritur konkurrueshmërinë në tregun e BE-së.

Plani i Rritjes bazohet në katër shtylla⁹:

1. Rritja e integritit ekonomik me tregun e përbashkët të Bashkimit Evropian;
2. Nxitja e integritit ekonomik brenda Ballkanit Perëndimor përmes Tregut të Përbashkët Rajonal;
3. Përsheptimi i reformave themelore;
4. Rritja e ndihmës financiare për të mbështetur reformat përmes një Fondi për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor për periudhën 2024-2027.

Qasja funksionale e BE-së, veçanërisht përparësia qëi jep ekonomisë dhe tregut në përputhje me reformat e kërkuara, duhet të përfshijë edhe Kuvendin.

Këto inpute nga Plani i Rritjes kanë nevojë për mbështetjen e Kuvendit dhe një konsensus të gjerë, veçanërisht kur ka një ndihmë financiare që mbështet të gjithë procesin e Planit të Rritjes.

Në këtë drejtim, Qeveria duhet të informojë Kuvendin në çdo fazë të zbatimit të Planit të Rritjes.

Për më tepër, Kuvendi, me me iniciativën e tij, duhet të veprojë në mënyrë proaktive

5 <https://kuvendwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202403201332150224KEMIP%20-%20Raport%20-Marr%C3%ABveshja%20per%20%20kualifikimet.pdf>

6 <https://kuvendwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202403181452039988KP%C3%87SSH%20-%20Komision%20p%C3%ABr%20dh%C3%ABnie%20mendimi.pdf>

7 <https://kuvendwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202403210742392490Raport%20marrev%20njohj%20kualifik%20mami%2C%20infirm%2C%20veteriner%20ne%20kuader%20te%20CEFTA%20Komis%20Jasht%20dhen%20mend.pdf>

8 <https://kuvendwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404080803579065Procesverbal%20dat%C3%AB%2021.3.2024.pdf.pg.90-98.>

9 https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/8f5d8e63-e951-4180-9c32-298cae022d03_en?file-name=COM_2023_691_New%20Growth%20Plan%20Western%20Balkans.pdf



dhe të nxisë Qeverinë të ndërmarrë veprime në funksion të zbatimit të Planit të Rritjes, së bashku me nismat e tjera të Procesit të Berlinit.

Nga ana tjetër, Procesi i Berlinit duhet të përfshijë dimensionin parlamentar si pjesë e këtij procesi duke marrë parasysh që përfituesi përfundimtar është qytetari i thjeshtë.

III. PROGRESI NË ZBATIMIN E PRIORITETEVE TË PËRBASHKËTA TË TREGUT RAJONAL: ZONA DIGJITALE RAJONALE DHE AGJENDA E GJELBËR

Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MEI) dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit po bëjnë përparim të rëndësishëm drejt zbatimit të Planit të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal - Zona Digjitale Rajonale. Përparimet kryesore përfshijnë rritjen e aksesit në internetin me fibra optike, me një përqindje rritjeje nga nga 17 në 20 për 100 njerëz, megjithëse zonat rurale vazhdojnë të hasin sfida. Po krijohen zyrat e Kompetencës për internetin me fibra optike, me legjislacionin e propozuar për mbështetjen e tyre. RASH në Shqipëri mundëson ndërlidhjen e rrjetit akademik dhe kërkimor me GEANT.

Plani i 5G përfshin lehtësimin e lejeve të ndërtimit për rrjetet e komunikimit elektronik. Përpjekjet për të reduktuar tarifat e roaming-ut dhe për të finalizuar planet për tarifa më të ulëta midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor janë në zhvillim e sipër. Për të siguruar akses të barabartë, po zhvillohen strategji për përmirësimin digjital, si dhe

janë duke u krijuar depozitë të programeve të trajnimit dhe plane të veprimit për edukimin digjital. Inicativat për ndërvëprimin e shërbimeve rajonale të ndihmës, përputhjen e standardeve të metadaten, promovimin e inteligjencës artificiale dhe lehtësimin e pjesëmarrjes së Ballkanit Perëndimor në Komputimin me Performancë të Lartë (HPC) janë në zhvillim e sipër. Megjithëse detajet specifike në lidhje me aktivitetet si takimet e nivelit të lartë, standardet e qyteteve inteligjente dhe përmirësimin e kapaciteteteve të sigurisë kibernetike nuk janë të disponueshme, mbikëqyrja legjislative siguron përputhshmërinë me standardet e mbrojtjes së të dhënave të BE-së, duke treguar përparim në mbrojtjen e privatësisë. Përpjekjet për të përmirësuar sigurinë kibernetike përmes bashkëpunimit me ENISA dhe rritjes së pjesëmarrjes së komunitetit të biznesit tregojnë një qasje gjithëpërfshirëse në transformimin digjital në Ballkanin Perëndimor.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës dhe Autoritetet Vendore kanë bërë përparime të ndryshme në zbatimin e Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër - Dekarbonizimi. Arritje të konsiderueshme përfshijnë harmonizimi i Ligjit për klimën të BE-së dhe vendosjen e objektivave ambicioze për energjinë dhe klimën deri në vitin 2030, duke rezultuar në emetime më të ulëta të gazeve serrë dhe rritje të integritimit të burimeve të rinovueshme të energjisë. Planet e integruara të energjisë dhe klimës, si dhe strategjitë e përshtatjes ndaj klimës, reflektojnë një qasje proaktive për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Megjithatë, sfidat mbeten, veçanërisht në implementimin e mekanizmave të çmimit të karbonit, vlerësimin e ndikimeve so-



cio-ekonomike dhe promovimin e efikasitetit të energjisë. Pavarësisht përpjekjeve për të zhvilluar infrastrukturën e transportit inteligjent dhe për të rehabilituar sistemet hekurudhore, përparimi në planet e mobilitetit urban të qëndrueshëm dhe infrastrukturën për karburantet alternative mbetet i kufizuar.

Mungesa e qymyrgurit në përzierjen e energjisë përfaqëson një hap pozitiv drejt dekarbonizimit. Shqipëria synon të arrijë përmirësim të vazhdueshëm deri në vitin 2030 dhe neutralitet të karbonit deri në vitin 2050, me një theks të veçantë në zhvillimin e një Strategjie Afatgjatë për Emisionet e Ulëta të Gazrave të Serë që është në përputhje me Ligjin e Klimës të BE-së dhe prioritetin për përfitimet e përbashkëta në reduktimin e ndotjes së ajrit.

Përpjekjet përfshijnë zbatimin e një sistemi për çmimin e karbonit, zhvillimin e vlerësimeve të ndikimeve socio-ekonomike dhe përditësimin e rregulloreve për cilësinë e ajrit. Zonat prioritare përfshijnë planifikimin e integruar për infrastrukturën e energjisë dhe transportit, si dhe strategjitë për transport të qëndrueshëm. Edhe pse është arritur përparim në disa fusha, është e nevojshme një përmirësim i vazhdueshëm për të arritur objektivat e dekarbonizimit të Shqipërisë.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturrës dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit në Shqipëri kanë bërë përparim të rëndësishëm në zbatimin e

Planit të Veprimit për Zonën Digjitale Rajonale, duke përfshirë:

- *Rritja e aksesit në internetin me fibra optike dhe fillimi i krijimit të Zyrave të Kompetencës për Broadband.*
- *Thjeshtimin e lejeve të ndërtimit për rrjetet e komunikimit elektronik si pjesë e planit të 5G .*
- *Zhvillimi i strategjive për avancimin e aftësive digjitale dhe sigurimin e aksesit të barabartë në arsim.*
- *Avancimi i iniciativave për ndërveprimin e shërbimeve rajonale të taksave dhe promovimin e inteligjencës artificiale.*

2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturrës dhe Autoritetet Lokale në Shqipëri kanë arritur rezultate të ndryshme në zbatimin e Agjendës së Gjelbër - Plani i Veprimit për Dekarbonizimin:

- *Përparim të konsiderueshëm në përputhje me Ligjin e Klimës të BE-së dhe vendosjen e objektivave ambicioze për energjinë dhe klimën.*
- *Sfida mbeten në implementimin e një sistemi për çmimin e karbonit dhe në promovimin e efikasitetit të energjisë. .*
- *Mungesa e qymyrit në përzierjen e energjisë paraqet një hap pozitiv drejt dekarbonizimit.*
- *Synimi është përmirësimi i vazhdueshëm drejt neutralitetit të karbonit deri në vitin*



2050 përmes planifikimit të integruar dhe strategjive për lëvizshmëri të qëndrueshme.

- 3. Qeveria duhet të informojë rregullisht Kuvendin për angazhimet e ndërmarra për Procesin e Berlinit dhe Planin e Rritjes.**
- 4. Qeveria duhet të ketë një plan të qartë për zbatimin e Procesit të Berlinit dhe Planit të Rritjes dhe të konsultohet me Kuvendin para miratimit.**
- 5. Kuvendi duhet të ketë një agjendë konkrete për mbikëqyrjen e Qeverisë për Procesin e Berlinit dhe Planin e Rritjes.**
- 6. Komisionet Parlamentare duhet të luajnë një rol aktiv për një përfshirje më të madhe në këto procese.**

ANALIZA E MATRICËS SË AKTORËVE PËRGJEGJËS

Për të dy prioritetet: Tregu i Përbashkët Rajonal – Zona Digjitale Rajonale dhe Agjenda e Gjelbër, niveli i zbatimit është i kënaqshëm.

Prioriteti 1: Tregu i Përbashkët Rajonal – SHQIPËRI

Përmbledhje e përgjithshme:

Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MEI) dhe **Ministria e Arsimit dhe Sportit në Shqipëri** kanë bërë progres drejt zbatimit të Planit të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal - Zona Digjitale Rajonale. Progresi përfshin përpjekjet për të rritur aksesin në internetin me fibra optike, me depërtimin në rritje nga 17 në 20 për 100 njerëz, megjithëse zonat rurale vazhdojnë të përballen me sfida. Krijimi i Zyrave të Kompetencës së Broadband (ZKB) është duke u zhvilluar, i ndihmuar nga legjislacioni i propozuar. RASH në Shqipëri lehtëson ndërlidhjen e rrjetit akademik dhe kërkimor në bashkëpunim me GEANT. Lejet e ndërtimit për rrjetet e komunikimit elektronik do të thjeshtësohen si pjesë e planit të 5G. Aktualisht po bëhen përpjekje për të reduktuar tarifat e roaming-ut dhe për të finalizuar planet për tarifa më të ulëta midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Po zhvillohen strategji për përmirësimin digjital, krijimin e bazave për

programe trajnimi, dhe planet e veprimit për edukimin digjital me qëllimin e arritjes së aksesit të barabartë. Përveç kësaj, janë duke u zhvilluar iniciativat për ndërveprimin rajonal të pikë-pagesave rrugore, harmonizimin e standardeve të metadatave, promovimin e inteligjencës artificiale dhe lehtësimin e pjesëmarrjes së BP-së në Komputimin me Performancë të Lartë të BE-së (HPC). Megjithatë, detaje specifike në lidhje me aktivitete të tilla si organizimi i takimeve të nivelit të lartë, vendosja e standardeve të qyteteve inteligjente dhe forcimi i aftësive të sigurisë kibernetike aktualisht nuk janë të disponueshme. Sidoqoftë, mbikëqyrja legjislative siguron respektimin e standardeve të BE-së për mbrojtjen e të dhënave, duke treguar përparim në mbrojtjen e privatësisë. Përpjekjet për të përmirësuar sigurinë kibernetike përmes bashkëpunimit me ENISA dhe rritjes së pjesëmarrjes së komunitetit të biznesit gjithashtu demonstrojnë një qasje gjithëpërfshirëse ndaj transformimit digjital në Ballkanin Perëndimor.

Niveli i zbatimit

Asnjë

Minor

Mesatar

Transformuese

MESATAR



REGIONAL COOPERATION THROUGH ENHANCED PARLIAMENTARY DIALOGUE

TREGU I PËRBASHKËT RAJONAL – ZONA DIGJITALE RAJONALE

Aktiviteti	Afati i dorëzimit	Ecuria (politikat, aktivitetet)	Institucioni/et përgjegjës/e	Hapi/at i/e radhës
1. Siguroni qasje fikse në internet me broadband për shumicën dërrmuese të familjeve	2024	Sipas Raportit të BE-së për Shqipërinë 2023, përhapja e broadbandit fiks u rrit nga 17 në 20 për 100 banorë në vitin 2021 dhe mbetet një problem, veçanërisht në zonat rurale. Këto kanë 40% të popullsisë, por vetëm një të katërtën e abonentëve me broadband fiks. Investimet në infrastrukturën digjitale janë të nevojshme edhe në shkolla. Shumë shkollave u mungojnë kompjuterët - ka rreth 0.2 kompjuterë për nxënës - dhe kanë lidhje të dobëta të internetit, gjë që mbetet pengesë për përdorimin e teknologjive digjitale në shkolla. Familjet me qasje në internet u rritën nga 88.3% në 2021 në 96.5% në 2022, me një pjesë në rritje të aksesit në internet përmes një lidhjeje fikse broadband.	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Infrastruktura digjitale e përmirësuar, duke përfshirë rritjen e përdorimit të fondeve të KIBP dhe instrumenteve të tjera të mundshme. Qasje fikse në internet me broadband për të paktën 95% të familjeve në secilën ekonomi të ofruar. Qasje fikse në internet me broadband për të paktën 90% të familjeve me shpejtësi të paktën 30Mbps në secilën ekonomi të ofruar. Qasje fikse në internet me broadband për të paktën 75% të familjeve me shpejtësi prej të paktën 100Mbps të azhurnueshme në 1Gbps në secilën ekonomi të ofruar.
2. Krijimi i Zyrave të Kompetencës së Broadband (BCOs) në BP (ku ato nuk ekzistojnë) dhe forcimi i kapaciteteve të tyre për të mbështetur vendosjen e broadband	2021	Në proces. MEI ka hartuar dhe Kuvendi ka përfshirë në procedura projektligjin për komunikimin elektronik	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës Drejtoria e Politikave dhe Strategjive për Zhvillim për Telekomunikacionin dhe Postat.	Fuqizimi i kapaciteteve të ZKB-ve duke përfshirë krijimin e bashkëpunimit një-për-një me ZKB-në e BE-së, bashkëpunimin e tyre të ndërsjellë dhe integrimin më të madh në rrjetin e ZKB-së së BE-së.
3. Ndërlidhja e rrjeteve akademike dhe kërkimore në BP6, me mbështetjen dhe bashkëpunimin e GEANT	2022	RASH Rrjeti Akademik i SHQIPËRISË është Rrjeti Kombëtar i Kërkimit dhe Edukimit (RrKKE) RASH ndërton dhe menaxhon Rrjetin Akademik Shtyllor dhe Rrjetet e Kampusit për universitetet dhe institucionet kërkimore. Infrastruktura elektronike e RASH është e lidhur me infrastrukturën e Rrjetit GÉANT, elementi themelor i infrastrukturës elektronike të Evropës, duke ofruar rrjet për përsosmëri shkencore, humlumtim, arsim dhe inovacion përmes ndërlidhjeve me 38 partnerët e saj NREN	Ministria e Arsimit dhe Sportit	U arrit ndërlidhshmëria e rrjeteve akademike dhe kërkimore në BP6. Bashkëpunimi rajonal dhe inovacionet e inkurajuar.

4. Zhvillimi i hartës rrugore 5G për Ballkanin Perëndimor dhe sigurimi i zbatimit efektiv në përputhje me afatin kohor të përcaktuar në të	2023	Sipas EU com 2023 për Shqipërinë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), së bashku me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, bënë një vlerësim mbi lejet e ndërtimit për rrjetet e komunikimit elektronik. U miratuan ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave për lejet e ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike, me qëllim thjeshtimin e procesit të dhënies së lejeve për vendosjen e rrjetit 5G Në proces	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Strategjitë 5G/Planet e Vepërimit të zhvilluara në secilën ekonomi; Veprimet e dakorduara rajonale (për shembull: harmonizimi i kohës dhe hapave në harmonizimin dhe caktimin e grupeve evropiane të pionierëve 5G, qasja e koordinuar në aspekte të zgjedhura të dhënies së 5G, kohëzgjatja minimale e licencës, përdorimi i spektrit të harmonizuar, etj.). Mbuloni të paktën një korridor kryesor rajonal me 5G deri në fund të vitit 2025. Mbuloni qytetet kryesore industriale me 5G në secilën BP6 deri në fund të vitit 2023.
5. Ulja e tarifave të roamingut brenda BP6 dhe BE-BP përmes zbatimit të Marrëveshjes së roamingut të BP-së dhe Udhërrëfyesit për uljen e tarifave të roamingut midis BE-së dhe BP-së	Nuk ka afat në AP	Sipas deklaratave zyrtare të kompanive mobile, tarifat janë ulur vazhdimisht për udhëtarët në rajonet e Ballkanit	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Në proces
6. Përfundimi i Planit të detajuar për uljen e tarifave të roamingut midis BE-së dhe BP-së dhe zbatimi efektiv në përputhje me afatin kohor të përcaktuar në të	2022	Në proces	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Në proces
7. Zhvilloni strategji të aftësive digjitale dhe bini dakord për veprime rajonale afatshkurtra dhe afatmesme për përmirësimin e aftësive digjitale	Vjetore	Në proces	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Në proces
8. Krijimi i një baze të kurseve dhe programeve të tjera të trajnimit të zhvilluara nga organizata të ndryshme, duke përfshirë MOOC me universitete të themeluara bazuar në analizën e boshllëkut të BP dhe nevojat e aftësive digjitale për grupin e synuar	2023	Në proces	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Në proces

9. Zhvillimi i Planeve të Veprimit për Arsimin Digjital dhe promovimi i barazisë në qasje, veçanërisht për grupet e pafavorizuara dhe pakicat, veçanërisht romët	2022-2024	Në proces	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Në proces
10. Organizimi i takimeve të rregullta të nivelit të lartë, duke përfshirë Samitin Vjetor Digjital, për të siguruar që agjenda digjitale të jetë në pararojë të transformimit rajonal	2023	Asnjë informacion nga ministria	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	
11. Përputhni standardet për metadatat për të dhënat e hapura në nivel rajonal bazuar në standardet e BE-së që do të zbatohen në të gjithë rajonin dhe nxisni parimin e të dhënave të hapura	2024	Në proces	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Në proces
12. Arritja e një marrëveshjeje për ndërveprimin rajonal të shërbimeve të pagesave në BP	2023-2024	Në proces	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Në proces
13. Dakordohuni mbi parimet dhe standardet e përdorura për qytetet inteligjente, bazuar në standardet e BE-së, me qëllim sigurimin e ndërveprimit të të dhënave dhe shërbimeve	2022	Asnjë informacion nga ministria	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	
14. Ndërmerrni veprime rajonale për të promovuar Inteligjencën Artificiale (IA) në aspekte të zgjedhura dhe bazuar në praktikatat e BE-së	Vjetore	Në proces	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Në proces
15. Ndërmerrni aktiviteteve rajonale për të lehtësuar pjesëmarrjen e BP në PLK të BE-së	2021 Pilot 2022-2023	Asnjë informacion nga ministria	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	

16. Ndërmerrni aktivitetet rajonale për të përmirësuar disponueshmërinë, analizën dhe monitorimin e statistikave të ekonomisë digjitale me cilësi të lartë, duke u mbështetur në DESI të BE-së dhe Indeksin e Zhvillimit të TIK-ut të ITU-së	2023	Asnjë informacion nga ministria	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	
17. Bashkëpunimi rajonal në lidhje me shkëmbimin e praktikave të mira në fushën e transformimit digjital, në veçanti e-qeverisjes	2023	Asnjë informacion nga ministria	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	
18. Dakordohuni për standardet dhe specifikimet minimale teknike për të lejuar shkëmbimin e të dhënave dhe dokumenteve, si dhe kryerjen e aktiviteteve pilot	2021-2024	Në proces	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Në proces
19. Përafrimi i veprimeve rajonale për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë në Ballkanin Perëndimor, bazuar në standardet e BE-së	2022-2023	Projektligji për komunikime elektronike në shqyrtim në Kuvend dhe është në përputhje me standardet e BE-së për mbrojtjen e të dhënave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Miratimi i ligjit
20. Zhvillimi i programeve të mentorimit për QZHIRT-të e BP-së dhe institucionet e tjera si bashkëpunim afatgjatë me QZHIRT-të e avancuara dhe partnerë të tjerë		Asnjë informacion nga ministria	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	
21. Forcimi i kapaciteteve të sigurisë kibernetike në rajonin e Ballkanit Perëndimor përmes bashkëpunimit me ENISA	2023	Asnjë informacion nga ministria	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	
22. Rritja e rezistencës së hapësirës kibernetike në BP përmes rritjes së pjesëmarrjes së komunitetit të biznesit në forcimin e kapaciteteve të sigurisë kibernetike në BP		Në proces	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Në proces

PRIORITETI 2: AGJENDA E GJELBËR – SHQIPËRI

Përmbledhje e përgjithshme:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës dhe Autoritetet Lokale në Shqipëri kanë arritur rezultate të ndryshme në zbatimin e Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër - Dekarbonizimi. Progres i konsiderueshëm është bërë, siç është harmonizimi me Ligjin e BE-së për klimën dhe vendosja e objektivave ambicioze për energjinë dhe klimën deri në vitin 2030, duke përfshirë një reduktim të dukshëm të emetimeve të gazeve serrë dhe rritje të integritimit të energjisë së rinovueshme. Përpjekjet për zhvillim të planeve të integruara të energjisë dhe klimës, si dhe strategjitë e adaptimit të klimës, demonstrojnë një qasje proaktive ndaj zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Megjithatë, mbeten sfida, veçanërisht në zbatimin e një sistemi çmimesh të karbonit, vlerësimin e ndikimeve socio-ekonomike dhe promovimin e efikasitetit të energjisë. Me gjithë përpjekjet e vazhdueshme për zhvillimin e infrastrukturës inteligjente të transportit dhe rehabilitimin e sistemeve hekurudhore, përparimi në planet e lëvizshmërisë së qëndrueshme urbane dhe infrastruktura për karburantet alternative mbetet i kufizuar. Mungesa e qymyrit në përzierjen e energjisë përfaqëson një hap pozitiv drejt dekarbonizimit. Sidoqoftë, ka një nevojë të qartë për përpjekje të vazh-

dueshme dhe bashkëpunim të rritur për të arritur objektivat e plota të dekarbonizimit dhe për të promovuar një të ardhme të qëndrueshme për Shqipërinë.

Shqipëria synon përmirësim të vazhdueshëm deri në vitin 2030 dhe neutralitetin e karbonit deri në vitin 2050. Planet përfshijnë krijimin e një Strategjie afatgjatë të emisioneve të ulëta të gazeve serrë që është në përputhje me Ligjin e Klimës të BE-së ndërsa përqendrohet në bashkë-përfitimet për uljen e ndotjes së ajrit bazuar në studime dhe strategji të ndryshme. Përpjekjet përfshijnë zbatimin e një sistemi për çmimin e karbonit, zhvillimin e vlerësimeve të ndikimeve socio-ekonomike, dhe përditësimin e rregulloreve për të bërë parashikime për ndikimet në cilësinë e ajrit.

Prioritetet përfshijnë planifikimin e integruar për infrastrukturën e energjisë dhe transportit, si dhe strategjitë e lëvizshmërisë së qëndrueshme. Ndërsa disa fusha kanë parë përparim, si rishikimi i korridoreve të transportit hekurudhor të mallrave dhe zhvillimin e një Strategjie të Mobilitetit të Qëndrueshëm dhe të Zgjuar për Ballkanin Perëndimor, të tjerë vazhdojnë të përballen me sfida, si mungesa e përparimit në iniciativa dhe strategji të caktuara. Përpjekjet e vazhdueshme për përmirësim janë kritike për objektivat e Shqipërisë për dekarbonizim.

Niveli i zbatimit

Asnjë

Minor

Mesatar

Transformuese

MESATAR

AGJENDA E GJELBËR – DEKARBONIZIMI – SHQIPËRI

Aktiviteti	Afati i dorëzimit	Ecuria (politikat, aktivitetet)	Institucioni/ et përgjegjës/e	Hapi/at i/e radhës
1. Në përputhje me Ligjin e BE-së për Klimën me një vizion për arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050.	2025	<p>Ligji 155/2020 “Për ndryshimet klimatike është miratuar në vitin 2020 dhe po zbatohet. Përafrohet me legjislacionin e BE-së: Direktivën 2003/87/KE dhe Rregulloren (BE). 525/2013. Në përputhje me përpjekjet e BE-së për ndryshimet klimatike dhe detyrimet tona përkatëse në procesin e anëtarësimit në BE, janë miratuar aktet ligjore të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ligji nr. 155/2020 për “Ndryshimet Klimatike” - Kontributi i përcaktuar kombëtar -Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës - Përafrimi i “Rregullores së Qeverisjes” - Ligji nr. 2/2023 “Për gazrat serë të florinuar” 	Ministria Turizmit dhe Mjedisit	<p>Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030</p> <p>Për të arritur neutralitetin e karbonit deri në vitin 2050, Shqipëria do të zhvillojë dhe miratojë Strategjinë afatgjatë për emetimin e ulët të gazeve serrë gjatë rishikimit të Strategjisë aktuale Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike, në përputhje me dispozitat e Ligjit të BE-së për klimën</p>
2. Vendosni objektiva afatgjata për energjinë dhe klimën deri në vitin 2030.	2022 (Në proces)	<p>Synimet e përcaktuara në PKEK të Shqipërisë deri në vitin 2030 përfshijnë një ulje prej 18.7% të emetimeve të gazrave serrë, një ulje prej 8.4% të konsumit përfundimtar të energjisë dhe një pjesë të konsiderueshme të integritimit të energjisë së rinovueshme në konsumin përfundimtar të energjisë, duke arritur në 54.4%</p>	Ministria Turizmit dhe Mjedisit Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Bazuar në studimin e KE, NDC, LCDS dhe PKEK; bashkë-përfitimet për uljen e ndotjes së ajrit.
3. Zhvillimi dhe zbatimi i Planeve të integruara të Energjisë dhe Klimës	2022 (Në proces)	<p>Qeveria e Shqipërisë filloi procesin e saj të planit kombëtar të përshtatjes (PKP) në shkurt 2015, me mbështetjen e GIZ dhe UNDP. Shqipëria është një nga vendet në rajonin e Ballkanit që ka zhvilluar dokumentin PKP. NAP dhe strategjia e tij e financimit u bënë pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike, dhe planet përkatëse të veprimit për zbutjen dhe përshtatjen, e cila u miratua nga qeveria më 2 korrik 2019.</p> <p>Miratimi nga qeveria e Shqipërisë i versionit fillestar të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) më 29 dhjetor 2021,</p> <p>Shqipëria duhet të përditësojë dhe zbatojë planin kombëtar të energjisë dhe klimës (PKEK) të miratuar në vitin 2021, në përputhje me objektivat e energjisë dhe klimës 2030.</p>	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Bazuar në studimin e KE; Zbatimi deri në vitin 2030.

4. Përgatitni dhe zbatoni strategjitë e përshtatjes ndaj klimës.	2028	<p>Shqipëria ka hartuar dhe zbatuar një numër të madh politikash, strategjish, planesh, programet, projektet dhe masat që lidhen me përshtatjen, siç renditen më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Strategjia Kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020; - Komunikimi i Tretë Kombëtar; - Politika Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe NSCC; - Plani Kombëtar i Përshtatjes; Plani i Përshtatjes për Tiranën; - Strategjia Kombëtare e Turizmit 2019-2023; - Politika Kombëtare e Pyjeve 2019-2030; - Plani i Integruar Ndër-sektorial për zonën Tiranë-Durrës; - Fondi i Gjellbër Klimatik i Programit Kombëtar për (FGjK), në të cilin ishte i bazuar <p>Metoda e pjesëmarrjes dhe dokumentet e mëparshme.</p>	Ministria Turizmit dhe Mjedisit	Bazuar në proceset e NAP.
5. Të harmonizohet me Sistemin e BE-së për Tregtimin e Emetimeve dhe/ose të prezantojë instrumente të tjera të çmimeve të karbonit	2024	<p>Monitorimi i cilësisë së ajrit ende nuk është në përputhje me standardet e BE-së</p> <p>Instrumentet e çmimeve të karbonit janë ende në proces</p>	Ministria Turizmit dhe Mjedisit	Bazuar në vendimin për prezantimin e çmimeve të karbonit, diskutimi i politikave është në vazhdim.
6. Rritja e mundësive për vendosjen e zgjidhjeve të bazuara në natyrë për të zbutur dhe përshtatur me ndryshimet klimatike	2025	<p>Me përshtatjen e PKA-së, Shqipëria është në procesin e identifikimit dhe adresimit të cenueshmërisë së vendit ndaj ndryshimeve klimatike dhe zhvillimit të strategjive dhe veprimeve për t'iu përshtatur ndikimeve të tij.</p> <p>Janë zbatuar projekte dhe programe të ndihmës ndërkombëtare, me mbështetjen e UNDP, GIZ, GEF, UNEP, FAO etj.</p>	Ministria Turizmit dhe Mjedisit	Përmirësimi i vazhdueshëm deri në vitin 2030; Lidhja me Veprimin 54
7. Të sigurojë pjesëmarrjen e ekonomive të BP në Paktin Evropian të Klimës ose të marrë në konsideratë zhvillimin e një mekanizmi të ngjashëm.	2022	<p>Shqipëria u angazhua për një objektiv të pakushtëzuar të reduktimit të emetimeve prej 20.9% deri në vitin 2030 krahasuar me biznesin si zakonisht.</p>	Ministria Turizmit dhe Mjedisit	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030.

8. Rishikimi, kur është e nevojshme, i të gjithë legjislacionit përkatës për të mbështetur dekarbonizimin progresiv të sektorit të energjisë	2023	Duhet të vazhdohet me hartimin dhe miratimin e legjislacionit përkatës, përfshirë krijimin e skemës së detyrimit për efikasitetin e energjisë dhe miratimin e rregulloreve për etiketimin. Po ashtu, është e nevojshme të vazhdohet me vlerësimin e plotë të potencialit të ko-generimit me efikasitet të lartë dhe ngrohjes së rajonit, në përputhje me obligimet e saj sipas Direktivës për Efikasitetin e Energjisë.	Ministria e Energjisë dhe Infrastruktura	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030.
9. Përgatitja e një vlerësimi të ndikimit socio-ekonomik të dekarbonizimit në ekonominë individuale dhe në nivel rajonal.	2022	nuk ka progres	Ministria e Energjisë dhe Infrastruktura	përgatitja e një vlerësimi të ndikimit socio-ekonomik të dekarbonizimit në ekonominë individuale dhe në nivel rajonal
10. Prioritizimi i efikasitetit të energjisë dhe përmirësimi i tij në të gjithë sektorët	(Në proces)	Shqipëria ende duhet të miratohet të gjithë legjislacionin e munguar zbatues për efikasitetin e energjisë. Asnjë mekanizëm i ri i financimit të efikasitetit të energjisë nuk është vendosur. Roli, kapacitetet dhe operacionet e agjencisë së efikasitetit të energjisë duhet të forcohen më tej	Ministria Turizmit dhe Mjedisit Ministria e Energjisë dhe Infrastruktura	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
11. Transpozimi dhe zbatimi i plotë i Direktivës së Performancës Energjetike të Ndërtesave.	2023	Duhet të vazhdojë hartimi dhe miratimi i legjislacionit zbatues, përfshirë përcaktimin e skemës së detyrimit për efikasitetin energjetik, si dhe miratimin e rregulloreve të etiketimit	Ministria e Energjisë dhe Infrastruktura	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030.
12. Mbështetja e rinovimit të ndërtesave private dhe publike dhe siguron financimin e duhur.	(Në proces)	Nuk ka progres	Ministria e Energjisë dhe Infrastruktura Autoritetet lokale	Zhvillimi i konceptit nga KE është në vazhdim; Përmirësimi i vazhdueshëm deri në vitin 2030.
13. Rritja e pjesës së burimeve të rinovueshme të energjisë dhe sigurimi i kushteve të nevojshme për investime	(Në proces)	Nuk ka progres	Ministria e Energjisë dhe Infrastruktura	Përditësimi i acquis është në proces; N.B: çdo rritje e djegies së biomasës duhet të bëhet duke marrë parasysh ndikimet e ndotjes së ajrit; Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030.

14. Ulja dhe heqja graduale e subvencioneve të qymyrit, duke respektuar në mënyrë rigorozë rregullat e ndihmës shtetërore.	(Në proces)	Shqipëria nuk ka qymyr në përzierjen e energjisë elektrike	Ministria e Energjisë dhe Infrastukturës	Duhet të tregohet në NECP; Përfitimet e përbashkëta të ajrit të pastër.
15. Të sigurohet pjesëmarrja në iniciativën Rajonet e Qymyrit në Tranzicion për Ballkanin Perëndimor.	(Në proces)	Nuk ka progres Shqipëria nuk ka qymyr në përzierjen e energjisë elektrike	Ministria e Energjisë dhe Infrastukturës	Bashkë-përfitimet e ajrit të pastër nga djegia e reduktuar e qymyrit
16. Zhvillimi i programeve për adresimin e varfërisë energjetike dhe skemat e financimit për rinovimin e familjeve dhe sigurimin e standardeve themelore të jetesës.	(Në proces) 2024	Nuk ka dokumente strategjike përkatëse që adresojnë çështjen e varfërisë energjetike	Ministria e Energjisë dhe Infrastukturës	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030.
17. Mbështet zhvillimin e infrastrukturës inteligjente të transportit, nxitjen e teknologjive inovative (si transporti pa letra, inteligjenca artificiale, biletat multimodale të pasagjerëve, lëvizshmëria si shërbim, aplikacionet e kalimit kufitar, korridoret 5G, etj.).	Në proces	Në proces Miratimi i ligjit për komunikimin elektronik lejon procedimin në të gjitha ato që kërkohen për të mbështetur zhvillimin e infrastrukturës inteligjente të transportit, dhe më shumë	Ministria e Energjisë dhe Infrastukturës	E rëndësishme për planifikimin e integruar të energjisë dhe infrastrukturës së transportit/tarifimit; Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030.

<p>18. Zbatimi i Planit Rajonal të Veprimit për Reformat Hekurudhore.</p>	<p>2023</p>	<p>Aktualisht, ka asistencë teknike të vazhdueshme për ristrukturimin e të gjithë sistemit hekurudhor Rehabilitimi i hekurudhës Durrës – Tiranë dhe ndërtimi i pjesës së re hekurudhore në Aeroportin Ndërkombëtar Nënë Tereza (Rinasi) (kostoja totale është 90.45 milionë euro). Tenderi për punimet e ndërtimit është në fazën përfundimtare.</p> <p>Rehabilitimi i linjës hekurudhore Vorë – Hani i Hotit. Përgatitja e dizajnit të detajuar ka filluar dhe financohet nga WBIF përmes një granti prej 4.5 milionë euro.</p> <p>Rehabilitimi i hekurudhës Durrës – Pogradeci – Lin dhe ndërtimi i një lidhje të re hekurudhore Lin – kufiri me Maqedoninë e Veriut (pjesë e Korridorit hekurudhor VIII). Studimi i fizibilitetit për këtë projekt ka përfunduar në janar 2018 dhe ka përfunduar projektimi paraprak i linjës hekurudhore Durrës – Rogozhinë, 34 km, (pjesë e këtij projekti). Granti WBIF merret për përgatitjen e Projektimit të Detajuar për segmentin hekurudhor Durrës – Rogozhinë; Me një grant prej 1.75 milion euro nga EIB do të fillojë në mars 2020 përgatitja e Projektimit Paraprak për Rindërtimin e Hekurudhës Rrogozhinë-Pogradec.</p> <p>Iniciativa hekurudhore e CB për përmirësimin e transportit ndërkufitar përmes lidhjes hekurudhore midis Krystallopigi dhe Pogradec (një aplikim i përbashkët midis Hekurudhave Greke dhe Ministrisë Shqiptare të Infrastrukturës dhe Energjisë, në kuadër të Programit INTERREG bashkëpunimi rajonal Shqipëri – Greqi, që vlerësohet të kushtojë 900,000 euro). Hekurudhat Shqiptare kanë identifikuar LC-të më kritike dhe do të marrin në konsideratë përmirësimin e mëtejshëm të tyre me buxhetin e shtetit ose donacionet/grantet</p>	<p>Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës</p>	<p>Përmirësimi i infrastrukturës nuk është i përfshirë.</p>
<p>19. Përcaktoni korridoret e transportit hekurudhor të mallrave dhe të rrugëve ujore të brendshme.</p>	<p>2027</p>	<p>Në proces</p> <p>Durrës – Rogozhinë – Elbasan – Pogradec – Lin</p> <p>Hekurudha Pogradec – Korçë – kufi me Greqinë</p> <p>Vorë – Hani Hotit kufiri me Malin e Zi</p> <p>Linjat hekurudhore Durrës – Terminali i Transportit Publik Tiranë dhe lidhja e re hekurudhore që mungon me Aeroportin Ndërkombëtar Tiranë Rinas TIA</p>	<p>Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës</p>	<p>Rrjeti i korridoreve të transportit hekurudhor të mallrave është nën rishikim nga KE.</p>

20. Përcaktoni një strategji të përgjithshme për të zhvendosur trafikun nga rruga në mënyra më miqësore me mjedisin.	2021	Në proces	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Strategjia e Mobilitetit të Qëndrueshëm dhe të Zgjuar për BP-në është përgatitur nga TCPS dhe është paraqitur në Këshillin Ministror të TCT-së.
21. Identifikoni standardet teknike të BE-së dhe siguroni zbatimin dhe digjitalizimin e tyre të gjitha mënyrave të transportit.	2030	Nuk ka progres	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
22. Zbatimi i Planit Rajonal të Veprimit për Lehtësimin e Transportit.	2023	Nuk ka progres	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Nuk ka progres
23. Zbatimi i Planit Rajonal të Veprimit për Sigurinë Rrugore.	2022	Në proces	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
24. Zbatoni Planin e Veprimit Rrugor.	2024	Në proces Janë disa projekte në zbatim lista e të cilave mund të gjendet në faqen e internetit të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës ¹⁰	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
25. Zhvillimi dhe zbatimi i planeve të qëndrueshmërisë klimatike për rrjetet e transportit të ekonomive të Ballkanit Perëndimor.	2022	Nuk ka progres	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Lidhja me Veprimin Klimatik.
26. Promovimi i përgatitjes dhe zbatimit të Planeve të Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane për zonat urbane në Ballkanin Perëndimor.	2025	Nuk ka progres	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Përfitimet e ajrit të pastër; Promovim i fortë deri në vitin 2025, Zbatimi që duhet ndjekur
27. Përcaktimi i zgjidhjeve të qëndrueshme të lëvizshmërisë në nivel rajonal, duke përfshirë planet për vendosjen e karburanteve alternative.	2024	Nuk ka progres	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Nuk ka progres
28. Përcaktoni një plan për vendosjen dhe ndërtimin e stacioneve të karikimit për automjetet elektrike.	2022	Nuk ka progres	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Nuk ka progres
29. Rritja e bashkëpunimit rajonal në fushën e zhvillimit të infrastrukturës së karburanteve alternative	2023	Nuk ka progres	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	Nuk ka progres